

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga një 'like' në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/nga-nje-like-ne-instagram-te-propaganda-serbe-si-u-shemb-b-skandali-i-kushte-i586126
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:23:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9e192505b7342dbd7d284a268954f25aac729b051cfaf76f3e0baff5a4ab765d
TEKSTI	39292ddaf4c661d735f5bbf9227ba3d843d0f5dacab81c16b66ac6a0334b6b95
PAMJA	c159e71b34e3006fb4e7d578d087779099d742358295fcd7ba1dba29274440a7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac9c303f072b246b263fcd406696f5600f7faab84c314ed495087cf37432391c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac9c303f072b246b263fcd406696f5600f7faab84c314ed495087cf37432391c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English




ie Nga një 'like' në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në TiranëVuçiq njofton doreheqjen me 27 shtator, bryn ne fushate per zgjedhjet fundit

Nga një 'like' në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë



14 Shtator 2026, 21:20Sport TEMA



Ndonjëherë mjafton një postim në Instagram, një foto e zgjedhur me kujdes dhe pak dramatizim për të krijuar një "skandal". Pastaj, nëse historia bie në duart e medias së duhur, ajo mund të marrë përmasa shumë më të mëdha sesa vetë ngjarja.

Kështu ndodhi edhe me historinë e një xhudisteje lituaneze gjatë Kampionatit Evropian të Universiteteve në Tiranë.

Marta Navickaitė zgjodhi rrjetet sociale për të shprehur pakënaqësinë e saj për kushtet e akomodimit. Problemi është se, sa më shumë që historia kontrollohet, aq më shumë fillojnë të dalin në pah kontradiktat mes asaj që u tregua dhe asaj që rezultoi të ketë ndodhur. Dhe në fund, "skandali" mbetet shumë më i vogël se zhurma që u krijua rreth tij.

Më shumë vëmendje në Instagram se në tatami?

Në vend që të mbahet mend për rezultatet në tatami, emri i xhudistes lituaneze u bë i njohur në Tiranë për një seri postimesh në rrjetet sociale. Në fokus ishin disa ambiente të paraqitura si të papastrat dhe një kavanoz kos, për të cilin pretendohet se ishte i prishur. Një mënyrë e sigurt për të tërhequr vëmendje.

Sepse një medalje, një rezultat apo një paraqitje sportive kërkojnë punë dhe rezultate. Një video me titullin "shikoni çfarë na kanë dhënë të hamë" mjafton për disa mijëra shikime. Dhe kështu, një kampionat universitar përfundoi duke u kthyer për të në një histori të rrjeteve sociale.

"Kosi i prishur" që doli të ishte...

Një nga momentet më të zhurmshme ishte kavanozi i kosit. Në videon e publikuar, produkti interpretohet si i prishur. Pamja e tij dhe ngjyra përdoren si argument për kushtet e këqija të ushqimit. Por pamjet e tjera tregojnë se bëhet fjalë për kos të shoqëruar me një paketë të veçantë reçeli frutash që përzihet nga konsumatori. Pra, "prova" e një produkti të prishur kishte një shpjegim shumë më të thjeshtë. Ishte kos me reçel.

Një detaj që e kthen një pjesë të rëndësishme të historisë nga "skandal ushqimor" në një keqinterpretim që u përdor për ta bërë situatën të dukej shumë më dramatike.

Pastaj hyri në lojë “propaganda serbe”

Deri këtu mund të flitej për një postim individual dhe për mënyrën se si një sportiste zgjodhi ta paraqiste eksperiencën e saj. Por historia mori tjetër përmasë kur u kap nga media serbe. “Kurir” e publikoi historinë duke e përcjellë narrativën e kushteve të këqija në Tiranë. Dhe pikërisht këtu duket qartë një tjetër element i kësaj historie: dëshira për ta interpretuar një episod individual në mënyrën më negative të mundshme për Shqipërinë.

Një postim në Instagram u kthye në “histori” për kushtet në Shqipëri. Pa shumë nevojë për kontekst. Pa shumë interes për versionin tjetër. Mjaftonte që historia ishte negative, vinte nga një sportiste e huaj dhe lidhej me Shqipërinë.

Por edhe pjesa e fotove të ambienteve nis të mos qëndrojë kur vendoset përballë dëshmimeve të drejtuesve të konvikteve. Drejtori Olsi Shahini, në një bisedë me gazetarin e Top Channel, Endi Tufa, ka sqaruar se disa nga fotot e përdorura si dëshmi për kushtet e këqija nuk ishin realizuar në dhomat ku ishin akomoduar sportistët. Sipas tij, disa sportiste kishin hyrë në një pjesë të godinës që ishte jashtë funksionit dhe kishin fotografuar ato ambiente.

Ndërkohë, dhomat ku ishin vendosur delegacionet në konviktet e Universitetit Bujqësor të Kamzës dhe Universitetit Ekonomik ishin ambiente të përgatitura dhe të mobiluara për kampionatin. Pra, edhe këtu historia fillon të marrë një tjetër ngjyrë.

Një godinë jashtë funksionit nuk mund të përdoret lehtësisht si fotografia e akomodimit të një delegacioni.

Dhe pastaj mbërrijnë pamjet pas largimit

Por ndoshta momenti më ironik i gjithë historisë vjen kur sportistët largohen. Pamjet e dhomave pas qëndrimit të tyre tregojnë shishe uji të lëna në dysheme, gata kafeje mbi shtretër, çarçafë të grumbulluar, mbeturina dhe bidona plastikë. Por jo vetëm kaq.

Në ambientet e lëna pas shfaqen edhe shishe alkooli, krahas kafesë, ujit dhe mbetjeve të tjera. Nuk është ky një argument për të thënë se të gjithë sportistët janë të papërgjegjshëm.

As nuk mund të pretendohet se çdo dhomë është lënë në të njëjtën gjendje. Por kontrasti është i pamohueshëm.

Një skandal që u kthye në bumerang

Nga fotot e sajuara për të krijuar një realitet që nuk ishte, te media serbe që nxitoi t’i vishte petkun e “skandalit”, historia përfundoi duke i lënë të dyja palët me gisht në gojë.

Ajo kërkoi “like”, ata kërkuan sensacionin. Por në fund, faktet ua prishën të dyve festën. /Top Channel

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ndeshjet e Ligës së Kombeve, zbardhet axhenda e Kombëtares

17:20 Sport

Rolando Maran rrëfen muajt e parë në Shqipëri: Ndihem si në shtëpi, vendosmërinë tuaj dua t'ua transmetoj lojtarëve!

15:00 Sport

"Koha e tij ka mbaruar" - Ancelotti konfirmon fundin e Neymarit me Brazilin: Ai nuk dëshiron të kthehet, tani fokusi është te lojtarët e rinj

12:50 Sport



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.